

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve; Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet
ADRESA	https://lapsi.al/te-rinjte-u-lene-vendin-te-moshuarve-punesimi-i-pensionisteve-dyfishohet-ne-tre-vjet-i1093896
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 05:18:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 05:12:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6fccc94faf2c78ba1016decefb3f63adc8740f4ee992add9f69c82b5827d7e40
TEKSTI	00a856608f527e9005e49e60583dfa0f28480d98cfc637cf7afb5ebe1c3fd55e
PAMJA	801e598ae410c0fd7d9f341b0324e70d8cd5e5fb6d568438b44a67f1a1cd68eb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bd4b476885a91a43bd67eb2ad5828238bc915f644193effc31c0d27cfb7a5c31
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6eceed1201b2ce8f4a73d4f507f3579b85ff06a11bd465eda29a5a7613bb438
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bd4b476885a91a43bd67eb2ad5828238bc915f644193effc31c0d27cfb7a5c31>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Të rinjtë u lënë vendin të moshuarve; Punësimi i pensionistëve dyfishohet në tre vjet



LAPSI.AL • 17 SEPTEMBER 2026



Numri i personave mbi 64 vjeç që vijnë të jenë të punësuar po rritet me ritme të shpejta, në një kohë kur të rinjtë po përballen me rritje të papunësisë dhe rënie të punësimit.

Të dhënat zyrtare të INSTAT tregojnë se në tremujorin e dytë të vitit 2026, numri i të punësuarve mbi 64 vjeç arriti në rreth 145 mijë persona. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kur ishin 131.2 mijë të punësuar, numri është rritur me rreth 13.7 mijë persona, ose 10.5%.

Rritja ishte edhe më e fortë në tremujorin e parë të vitit. Në janar-mars 2026 në tregun e punës kishte 140.7 mijë të punësuar mbi 64 vjeç, me rritje prej 14.4% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Zgjerimi i punësimit në moshat më të mëdha po ndodh në një treg pune ku kompanitë po e kanë gjithnjë e më të vështirë të zëvendësojnë punonjësit që dalin në pension.

Emigracioni dhe tkurrja e brezave të rinj që hyjnë në tregun e punës kanë kufizuar ofertën për punonjës, ndërsa jo gjithmonë aftësitë dhe profilet e të rinjve përputhen me vendet e lira që kërkojnë të plotësojnë bizneset.

Në disa sektorë, mungesa e përvojës profesionale, kërkesa për aftësi specifike dhe interesi më i ulët i të rinjve për disa profesione apo zanate e bëjnë më të vështirë zëvendësimin e punonjësve të vjetër.

Shumë biznese mendojnë se mbajtja në punë e një punonjësi me eksperiencë mund të jetë më e lehtë sesa gjetja dhe trajnimi i një punonjësi të ri.

Të dhënat tregojnë se rritja e punësimit mbi moshën 64 vjeç është bërë më e qëndrueshme që nga fundi i vitit 2024.

Në një krahasim më afatgjatë, ndryshimi është edhe më i fortë. Në tremujorin e dytë të

ide



Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

16°C

KËMBIMIEURO

91.71

aktuale

21:32

Grenell: Kurti të shpërbëjë Hagën, ka gjyqtarë të çmendur të së majtës

13:46



BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbytje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



vitit 2023 numëroheshin vetëm 71 mijë të punësuar mbi 64 vjeç, ndërsa tre vjet më vonë numri mëse u dyfishua.

Përveç kërkesës së bizneseve për punonjës me përvojë, vazhdimi i punës pas moshës 64 vjeç mund të lidhet edhe me nevojën për të siguruar të ardhura shtesë.

Për një pjesë të personave që kanë arritur ose po i afrohen moshës së pensionit, qëndrimi në tregun e punës mbetet një mënyrë për të plotësuar të ardhurat familjare. Teksa pagat dhe kostot e jetesës po rriten, pensionet e reja të pleqërisë nga viti në vit po vijnë në ulje.

Ata që dolën në pension vitin e kaluar përfituan mesatarisht 14,496 lekë në muaj ose 3 për qind më pak se ata që dolën në pension me 2024. Kështu që për shumë të moshuar aktivizimi në tregun e punës mbetet e vetmja mundësi për mbijetese.

Të dhënat zyrtare të Eurostat tregojnë se sistemi i pensioneve në Shqipëri regjistron shkallën më të ulët të zëvendësimit në të gjithë hapësirën europiane. Pensioni mesatar bruto në vend përfaqëson vetëm 30% të pagës mesatare të grupit moshor aktiv 50-59 vjeç.

Ky nivel e pozicionon Shqipërinë jo vetëm në fund të Ballkanit Perëndimor, por edhe në skajin më të ulët krahasuar me të gjitha shtetet e Bashkimit European, ku mesatarja e bllokut është e qëndrueshme, në rreth 57-60% të pagës mesatare.

Në një tjetër raport të Anketës Europiane të Kushteve të Punës (EWCS 2024), Shqipëria ka nivelin e pensionit ndër më të ulët në Europë, burrat shqiptarë janë ata që duan të lënë punën më vonë se çdo popull tjetër në Europë.

Mesatarisht, ata deklarojnë se do të dëshironin të punonin deri në moshën 67.4 vjeç, niveli më i lartë mes 35 vendeve të analizuara, që përfshijnë vendet e Bashkimit European, Ballkanin Perëndimor, vendet e EFTA-s dhe disa shtete të tjera europiane./ B.Hoxha

Kriza e pensioneve, janë sa 30% e pagës; Shqipëria me zëvendësimin më të ulët në Europë

Pensioni që nuk del: 27% e popullsisë në moshë pensioni drejt kufirit të varfërisë ekstreme

Pasiguria financiare, burrat shqiptarë, rekord në Europë për moshën kur duan të dalin në pension

Të këshilluara



“Ditë e kobshme”, Walker: Kosova do të shihet tani me një sy tjetër

“Ditë e kobshme” e ka cilësuar diplomat amerikan në pension, William Walker, vendimin e sotëm të Gjykatës Speciale n...



Nga torturat te vrasja e 96 personave/ Pse i dënoi Haga katër ish-krerët e UÇK-së



"Marre", Ramën e bëjnë copë në rrjetet sociale pas dënimit të Hashim Thaçit



VIDEO/ Del nga SPAK arkitekti që projektoi vilën e Belinda Ballukut




Departamenti amerikan i Shtetit i vë kapakun, përshëndet dënimin e ish-krerëve të UÇK

Ziarr në objektin e EULEX-it, protestuesit



hedhin fishekzjarre

Pas verdiktit të Gjykatës Speciale, protestuesit janë rikthyer tek zyrat e EULEX-it. Protestuesit kanë hedhur fishekzjarre në drejtim ...



Zbulohet ditari i Rexhep Qoses/ Çfarë shkroi ditën që ish-krerët e UÇK u dërguan në Hagë



Dalin për herë të parë PAMJET/ Dëmet që Irani u ka bërë bazave të SHBA në Lindjen e Mesme

Një avion i dëmtuar, tenda të grisura, ndërtesa të shkatërruara. Sulmet iraniane kanë shkaktuar dëme të mëdha...



Arrestohet ish-drejtori i Kadastrës në Fier, veprimet e tij janë denoncuar edhe në SPAK 2 vite më parë

Me urdhër të Prokurorisë së Fierit është arrestuar ish-kreu i Kadastrës, Ertis Shehu dhe biznesmeni Kastriot Hasko. Ar...



Protesta e 109-të kundër Ramës mbyllet te busti i Adem Jasharit: Marshim për UÇK-në

Protesta e 109 kundër qeverisë dhe kryeministrit Edi Rama u shoqërua me thirrjet "Arrestoni Ramën", "Arrestoni Ballukun&r...



Reagon djali i Hashim Thaçit: Kjo betejë nuk ka mbaruar



Provokimi i gazetës gjermane: Pra perëndimi bashkëpunoi me një kriminel lufte

"Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, është dënua me 25 vjet burg. Për Perëndimin, kjo mund të nënkupt...



Vendimi i Hagës, vijon protesta në Prishtinë

Situata para Qeverisë së Kosovës është tensionuar, pasi disa protestues kanë tentuar të thyjnë kordonin policor. Prote...



48 ditë protestë në Divjakë, kundërshtohet shkrimi e bashkisë

Banorët e Divjakës kanë vijuar për të 48-n ditë me radhë protestojnë në kundërshtim të reformës ter...

Me sytë katër



22:48


PAMJET/ 12 vite më parë Thaçi qeshte kur Albin Kurti i kërkoi të mos e votonte Specialen

Në prill të vitit 2014, kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, asokohe deputet i Parlamentit, paralajmëroi Hashim Thaçin pë...



PAMJET/ Shqiptarët "pushtojnë" gjykatën e Hagës para vendimit për krerët e UÇK-së

21:25



"O hajdut, o hajdut...", shihni si iu ikën protestuesve Taulant Balla (VIDEO)

28:44



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

28:36




Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Europa League, Milan–Benfica 0-2: debutim horror për Djallin, portugezët triumfojnë në San Siro

Stirling dhe aksidenti me Lamborghini: pranon fajësinë, videot dhe dëshmitarët e fundosin

Dartina Roemari namu betejën me kancerin: Ronald i dëshpëruar nga humbja e bashkëshortes




Milan dhe Juventus i aso



Webb pranon gabimin e rëndë të VAR-it në derbin



Messi u tërhoq nga Argentina: Scaloni e



Cristiano Ronaldo turpërohet 4-0 në Champions: hedhie

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.